



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE

Nr Rregj. 448  
Date regj 11.10.2013

Nr. 448 Vendimit  
Data 31.10.2013

V E N D I M  
"Ne emer te Republikes"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë prej

**ARQILE BASHO - GJYQTAR**

Asistuar nga sekretare séances Anila Rista, sot më datë 31.10.2013 përfundoi në seancë gjyqësore publike shqyrtimin e kërkesës penale që I përket:

**KERKUES:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë  
- përfaqësuar nga prokurori ~~XXXXXXXXXX~~

**OBJEKTI:** 1. Shqyrtimin e sekuestros te vendosur ndaj Mjetit Lundrues "gomone" me gjyre gri e te bardhe, me mbishkrimin "NADIR", me gjatesi 9.3 m, gjeresi 3m, me dy motora model "YAMHA" 250hp jashte bordit.  
2. Konfiskimin e Mjetit Lundrues.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr 8663, dt 18.09.2000 "Per rregjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT"

**Në perfundim te shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes u kerkua:**

**Prokuroria:** 1. Te konsiderohet I ligjshem sekuestrimi I mjetit lundrues.  
2. Te konfiskohet mjeti lundrues.

Gjykata, pasi degjoi prokurorin, shqyrtoi provat e paraqitura dhe ceshtjen ne teresi

V E R E N

Prokuroria e Rr.Gj.Vlore ka parashtruar kerkesen me object "Shqyrtimin e sekuestros te vendosur ndaj Mjetit Lundrues "gomone" me gjyre gri e te bardhe, me mbishkrimin "NADIR", me gjatesi 9.3 m, gjeresi 3m, me dy motora model "YAMHA" 250 hp jashte bordit dhe Konfiskimin e Mjetit Lundrues.

**Nga shqyrtimi gjyqesor I kerkeses rezultoi e provuar se:**

Sherbimet e Policise Gjyqesore prane Drejtorise rajonale te Policise Kufitare dhe Migracionit Vlore, ne ndaten 05.10.2013, rreth ores 22.30' kane gjetur te ndezur dhe te braktisur ne zonen midis grykededhjes te lumit Vjose dhe plazhit prane fshatit Darzeze Fier, rreth 100 m ne det larg bregut Mjetit Lundrues, "gomone" me gjyre gri e te bardhe, me mbishkrimin "NADIR", i pamatrikulluar, me gjatesi 9.3 m, gjeresi 3m, me dy motora model "YAMHA" 250hp jashte bordit.

Sherbimet e Policise kane kryer kontrollin dhe kane pasqyruar te dhenat e mjetit lundrues dhe te provave materiale dhe faktin e shkeljes se Ligjit Nr 8663, dt 18.09.2000 "Per rregjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT" dhe konkretisht nenin 23, pika 1 "Mosdeklarimi I zoterimit ose I mbajtjes" dhe neni 24, pika 1 "Mungesa e matrikullimit ose e rregjistrimit".

Ne vijim te veprimeve, Policia Gjyqesore ka vendosur sekuestrimin e mjetit lundrues te gjetur me "Proces-Verbal, mbi sekuestrimin e mjetit lundrues" dt 06.10.2013, Proces-Verbal qe I eshte komunikuar brenda 48 oreve Prokurorit.

Prokurori, me Vendim per vlefesimin e sekuestrimit dt 09.10.2013, ka vendosur vlefesimin te ligjshem te sekuestrimit te kryer nga Policia Gjyqesore me Proces-Verbalin perkates.

Ne keto rrethana Prokurori ne daten 11.10.2013, ka parashtruar ne Gjykate kerkesen me object konfiskimin e mjetit lundrues.

**Rrethanat e mesiperme u provuan ne gjykim me:**

- Raport Sherbimi dt 05.10.2013, ora 20.30'.
- Procesverbal i Konstatimit te Shkeljes dt 05.10.2013, ora 20.30'.
- Procesverbal per kqyrjen dhe marrjen e proves materiale (mjetit lundrues).
- Procesverbal per sekuestrimin e Mjetit Lundrues dt 06.10.2013.
- Vendim per vlefesimin e sekuestros dt 09.10.2013.

- Procesverbal per dorezimin dhe lenien ne ruajtje te mjetit lundrues ne Piken e Bllokimit.
- Aktet e dokumentacionit te Mjetit Lundrues ne gjuhen italiane.
- Si dhe akte te tjera te vep[primeve proceduriale bashkelidhur kerkeses.

**Ne keto rrethana dhe mbi percaktimin e Ligjit Gjykata vlereson:**

Rrethanat e parashtuara nga Prokurori dhe qe lidhen me faktin penal te ndodhur provohen plotesisht me aktet e veprimeve hetimore te kryera nga sherbimet e policise gjyqesore.

**I -** Në nenin 23, pika 1, e ligjit nr 8663 dt 18.09.2000 percakton:

“Mosdeklarimi I zotërimit ose I mbajtjes siç parashikohet në nenin 12, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.”

Në nenin 12 të ligjit 8663 dt 18.09.2000 percakton:

“1. Cilido që zotëron ose mban, me çfarëdo lloj titulli, një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarimin me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose mbajtja, në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbazimin e përhershëm të mjetit, si dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.”

Në nenin 13 i ligjit 8663 dt 18.09.2000 percaktohet detyrimi i pronareve te mjeteve lundruese qe brenda 24 oreve nga casti I ndryshimit te njoftojne me shkrim ndryshimin e pronarit, vendbanimit dhe vendbazimit te mjetit lundrues.

Ne piken 2 parashikohet: “Oficeri ose agjenti I policies kufitare, qe ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton proceduren e parashikuar ne pikat 3, 4, 5, e 6 te nenit 31.”...

Neni 31 i ligjit 8663 dt 18.09.2000 percakton: “1. Oficeri I policies gjyqesore I zyres se policies kufitare, pergjegjes per territorin, me vendim te gjykates, kontrollon ne vendet ku ka te dhena te bazuara se fshihen ose mbahen ne menyre te paligjshme mjete lundruese, object I ketij ligji, ne kundershtrim me nenet 11, 12, 17, e 18 te ketij ligji.

2.Oficeri I policise gjyqesore mund te veproje me nismen e vet ne rastet e flagrances, sipas kritereve te percaktuara ne Kodin e Procedures Penale. ...

...6. Oficeri I policies gjyqesore I dergon prokurorit process-verbalin e mesiperm brenda 48 orve, I cili brenda 48 oreve ne vijim vlereson kontrollin.”

**II -** Ligji I posacem qe parashikon kryerjen e veprave apo kundervajtjeve penale me mjetet lundruese, ka percaktuar menyren e posacme te kryerjes se

veprimeve nga ana e organit procedures. Ne lidhje me menyren e procedimit per kryerjen e sekuestrimit dhe te konfiskimit te mjeteve lundruese Ligji ka percaktuar konkretisht:

Neni 23, pika 1 dhe 2 e Ligjit nr 8663 dt 18.09.2000 percakton:

"... 2. Oficeri ose agjenti I policies kufitare, qe ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedure e parashikuar ne pikat 3, 4, 5, e 6 te nenit 31.

1. Gjykata, brenda 15 (pesembadhjete diteve nga marrja e mases se sekuestrimit, vendos per konfiskimin e mjetit lundrues".

**Gjykata vlereson** se me rrethanat e shqyrtuara, provohet fakti penal I zoterimit, perdorimit dhe mosdeklarimit ten je mjeti lundrues. Ky fakt penal perben veper penale te parashikaur ne Ligjin e posacem.

Ne Ligjin Nr 8663, dt 18.09.2000 "Per rregjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT" parashikohen veprat penale ne kete fushe dhe veprimet e posacme te Sherbimeve te Policise per kryerjen sekuestrimit dhe procedimit mbi mjete lundruese. Me kete percaktim te drejteperdrejte te Ligjit, organi I procedimit ka detyrimin qe, me kryerjen e sekuestrimit te mjetit lundrues, te kerkoje ne gjykate konfiskimin e mjetit lundrues si dhe te procedoje me Procedimin penal per kryerjen e veprave penale.

Ne rastin konkret provohen plotesisht rrethana te kryerjes se vepres penale nga autore te pidentifikuar. Rrjedhimisht organi I ndjekjes penale duhet te rregjistroje dhe te hetoje me procedimin penal qe lidhet me kete fakt penal.

Nga ana tjeter, Gjykata vlereson se ne rastin konkret, rezultojne te gjitha rrethanat qe percaktojne gjendjen e flagrances te parashikaur ne nent 251 e vijues te K.Pr.Penale.

Neni 23 I Ligjit ka parashikuar dhe autorizuar veprimet e Oficerit te Policise Gjyqesore ne gjendjen e flagrances dhe veprimet e Policise Gjyqesore jane ne perputhje me percaktimet e p[osacme te Ligjit.

**Ne rastin konkret**, prokurori ka zbatuar procedimin ligjor per kryerjen e konfiskimit te mjetit lundrues. Marrja e mases per sekuestrimin e mjetit lundrues ne rastin konkret eshte kryer dt 06.10.2013, Sekuestrimi eshte vlefesuar nga Prokurori brenda afatit ligjor te percaktuar ne nenin 31, pika 6 te Ligjit dhe kerkesa eshte parashtruar ne gjykate brenda afatit te percaktuar ne nenin 31 pika 1 e Ligjit.

Ne keto rrethana Gjykata vlereson se procedimi i te gjitha veprimeve te Sherbimeve te Policise Gjyqesore jane ne perputhje te plote me Ligjin Nr 8663, dt 18.09.2000 "Per rregjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe

kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT" dhe kerkesa per konfiskimin e mjetit lundrues duhet te pranohet.

### PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 379 e vijues të K.Pr.Penale dhe Ligjit Nr 8663, dt 18.09.2000 "Per rregjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT"

### VENDOSI

- Pranimin e kerkeses se Prokurorise se Rr.Gj.Vlore.
- Vleftesimin te ligjshem te sekuestrimit te Mjetit Lundrues "gomone" me gjyre gri e te bardhe, me mbishkrimin "NADIR", i pamatrikulluar, me gjatesi 9.3 m, gjeresi 3m, me dy motora model "YAMHA" 250hp jashte bordit.
- Konfiskimin e Mjetit Lundrues "gomone" me gjyre gri e te bardhe, me mbishkrimin "NADIR", i pamatrikulluar, me gjatesi 9.3 m, gjeresi 3m, me dy motora model "YAMHA" 250hp jashte bordit, dhe kalimin e tij ne pronesi te shtetit.
- Shpenzimet gjyqesore I ngarkohen prokurorise.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda dhjetë ditëve duke filluar nga e nesërmyja e shpalljes.

U Shpall në Vlorë sot më datë 31.10.2013.

SEKRETARE  
ANILA RISTA



GJYQTAR  
ARQILE BASHO



VENDIMI MORI FORME TE PRERE  
PASI NUK U ANKIMUA  
Duke nje daten 11.11.2013  
K/SEKRETARE  
REZARTA TAUSHANI

*Secundare*

*Trup Drejtues*  


